

Vendim nr. 215 datë 30.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 30.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (B) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BARDHYL XHAFA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-867, datë 25.02.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimi i procedurave dhe shpërblimi i dëmit, për sa i përket çështjes me nr. 31154-00792-86-2023 akti, datë regjistrimi 28.03.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 71, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi pretendon të jetë pronari i një ndërtese banimi dhe trualli të ndodhur në qytetin e Fierit, të trashëguar nga i ati i tij. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (*IMT*) pranë Bashkisë Fier ka nxjerrë urdhrin nr. 12, datë 02.09.2015 për heqjen e objektit ndërtesë banimi dhe lirin e hapësirave publike, si dhe ka ndërhyrë duke nxjerrë jashtë banesës kërkuesin dhe familjarët e tij (bashkëshorten, djalin, nusen e djalit dhe mbesën 2-vjeçare në atë kohë).

2. Në 24.12.2015 kërkuesi ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kërkuar: (i) shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nr. 12, datë 02.09.2015, si dhe të akteve të tjera të nxjerra nga Bashkia Fier dhe IMT-ja; (ii) detyrimin e Bashkisë Fier për kompensim financiar për prishjen e ndërtesës me sipërfaqe 100 m²; (iii) dëmshpërblimin për pagesën e qirasë së paguar pas largimit nga banesa; (iv) dëmshpërblimin për dëmtimin e murit rrethues të truallit; (v) shpalljen e pavlefshmërisë së pjesshme të vendimit nr. 28, datë 16.09.2015 të këshillit bashkiak Fier.

3. Me vendimin nr. 484, datë 06.04.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, i cili është regjistruar në muajin shtator të vitit 2016, pasi, sipas kërkuesit, vendimi i arsyetuar nuk është dorëzuar në afatin ligjor nga gjyqtari i çështjes, shkak për të cilin ai ka paraqitur ankesë ndaj tij në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

4. Me vendimin nr. 4109, datë 15.11.2018, Gjykata Administrative e Apelit ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka pushuar gjykimin e çështjes. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, për rekursin e kërkuesit, me vendimin nr. 00-2023-666 (61), datë 16.02.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë për vijimin e gjykimit. Për rrjedhojë, çështja e kërkuesit është regjistruar në gjykatën e apelit me nr. akti 31154-00792-86-2023, datë regjistrimi 28.03.2023.

5. Në datën 12.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes. Me vendimin e datës 15.10.2024 gjyqtari relator, në bazë të nenit 460, pika 3, të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ka vendosur pranimin e kërkesës dhe urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për

planifikimin e çështjes në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve. Sipas kërkesës, pas pranimit të kërkesës për përshpejtimin e gjykimit është zhvilluar një seancë në datën 14.11.2024, ku trupi gjykues është dorëhequr dhe megjithëse është caktuar një seancë tjetër gjyqësore në datën 22.01.2025, ai nuk është informuar se çfarë ka ndodhur dhe nuk ka arritur të gjejë informacion të mëtijshëm në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit.

6. Në datën 22.10.2024 kërkesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së tij me nr. 31154-00792-86-2023, e cila ndodhet për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (gjyqtari i vetëm) ka konstatuar se kërkesa nuk përmbushte kushtet e parashikuara në nenet 474 dhe 399/5 të KPC-së, pasi nuk është nënshkruar nga një avokat, sipas nenit 56/a, shkronja “d”, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, për rrjedhojë, me vendimin e datës 28.10.2024, i ka lënë kërkesit një afat 5-ditor për plotësimin e të metave të kërkesës. Për arsye se nuk është ndrequr kjo e metë dhe kërkesi nuk ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesën e nënshkruar rregullisht nga mbrojtësi, me vendimin nr. 00-2025-867, datë 25.02.2025, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm.

7. Në datën 09.06.2025 kërkesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkesit

8. **Kërkesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është *cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 6, pika 1, i KEDNJ-së, për sa i përket së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka të bëjë me ankimin kundër vendimit nr. 484, datë 06.04.2016 të

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Gjykata e Lartë, nga ana tjetër, ka interpretuar gabim natyrën e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përsheptimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, duke kërkuar përfaqësim të detyrueshëm me avokat, ndonëse kjo nuk është e parashikuar për kërkesat, sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Për rrjedhojë, kërkuesi ka kërkuar edhe përsheptimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

11. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, për sa i përket çështjes me nr. 31154-00792-86-2023 akti të Gjykatës Administrative të Apelit. Gjatë kohës që çështja ishte e regjistruar në gjykatën e apelit, në pritje të gjykimit, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes në bazë të nenit 460, pika 3, të KPC, kërkesë kjo e miratuar nga gjyqtari relator më 15.10.2024. Duke pretenduar se në atë gjykatë është zhvilluar një seancë më 14.11.2024, ku trupi gjykues ka dhënë dorëheqjen dhe se në vijim nuk ka marrë më informacion për çështjen, më 22.10.2024, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Ajo gjykatë e ka kthyer kërkesën si të paplotë për shkak të mosnënshkrimit të saj nga një avokat.

13. Gjykata ka theksuar se kërkuesi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton që kërkuesi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike, të afta për të rivendosur të drejtën, që pretendohet se është shkelur. Në të kundërt, vetë Gjykata rrezikon të mos konsiderohet si një “mjet efektiv”. Mjeti juridik përshpejtues është “efektiv” nëse përshpejton vendimmarrjen e gjykatës në fjalë, ndërkohë që, bazuar në parimin e subsidiaritetit, i cili bën të mundur shmangien që individët t'i drejtohen sistematikisht kësaj gjykate për pretendime që do të ishin shqyrtuar më mirë brenda sistemit juridik kombëtar, aty ku është parashikuar një mjet juridik i brendshëm, ajo vlerëson nëse mjeti është ose jo efektiv (*shih vendimin nr. 11, datë 28.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në lidhje me këto mjete juridike, Gjykata ka theksuar se, si rregull, për sa i përket cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të tejzgjatjes ose zvarritjes së procedurave, mjeti efektiv për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave i përket gjyqësorit të zakonshëm, ndërkohë që Gjykata investohet vetëm për riparimin e shkeljeve të kryera nga ato gjykata, në rast se ato nuk janë në gjendje të korrigjojnë dhe të riparojnë shkeljen e së drejtës për proces të rregullt, pra në rast se provohet se mjeti juridik nuk ka qenë efektiv (*shih vendimin nr. 11, datë 28.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kolegji, bazuar në informacionin e dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit, për nevoja të shqyrtimit paraprak të çështjes, vëren se me vendimin nr. 20 (986-2025-24), datë 22.01.2025 të asaj gjykate është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 484, datë 06.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Kolegji vëren se kërkesa në Gjykatën e Lartë për konstatimin e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt, për shkak të tejzgjatjes së procedurave të gjyqimit në gjykatën e apelit dhe për përshpejtimin e tyre, është paraqitur më 22.10.2024, vetëm pak ditë pas pranimit të kërkesës për përshpejtim nga gjyqtari relator, më 15.10.2024. Seanca e radhës në Gjykatën Administrative të Apelit është zhvilluar në datën 14.11.2024 dhe vendimi për themelin e çështje është marrë në datën 20.01.2025, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë, në një kohë që kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin dhe shpërblimin e dëmit ishte në shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Për më tepër, në momentin e paraqitjes nga kërkuesi të ankimit kushtetues individual, çështja rezulton se kishte përfunduar së gjykuari nga gjykata e apelit.

16. Kolegji vëren se mjetet e reja juridike që parashikon legjislacioni në dispozicion të individit janë testuar për efektivitetin e tyre në një situatë jo të zakonshme të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe zhvillimit të procedurave gjyqësore. Për këtë arsye, është e nevojshme që edhe vetë individi të tregojë kujdesin e duhur, në kohën e duhur. Një qasje e tillë përputhet me qëllimin e mjeteve juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, si dhe me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e zakonshme nuk kanë qenë në gjendje të riparojnë shkeljet e së drejtës për proces të rregullt (*shih vendimin nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rast se individi nuk i shteron mjetet juridike në momentin dhe kohën e duhur, në përputhje me mundësitë dhe të drejtat që i ofron legjislacioni i zakonshëm për korrigjimin e shkeljes së pretenduar dhe, për më tepër, nëse nuk provon se këto mjete janë joefektive, kjo nuk nënkupton se ai mund të rivendoset në të drejtën për të ngritur pretendime në Gjykatë në përfundim të të gjithë procesit gjyqësor, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes tërësore të procesit (*shih vendimin nr. 11, datë 28.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi edhe pse kishte në dispozicion mjetin juridik të konstatimit të cenimit të së drejtës për kohëzgjatje të arsyeshme të gjyqimit nuk e ka përdorur atë në kohën dhe formën e duhur, ndërkohë që paraqitja e një kërkesë të tillë në Gjykatën e Lartë dhe më tej paraqitja e ankimit kushtetues individual në këtë Gjykatë kanë qenë formale,

për sa kohë që kërkesa për përshpejtimin e gjykimit kishte rezultuar të ishte efektive në drejtim të arritjes së rezultatit të synuar. Në këtë mënyrë, konsiderohet se kërkuesi nuk ka përdorur mjetet e reja ligjore të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, për rrjedhojë konsiderohet se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

18. Në këndvështrim të sa më lart, duke qenë se kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë kumulative, Kolegji vlerëson se analiza e mëtejshme e plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të kërkuarit bëhet e panevojshme.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjën “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.